



# Doracaku për Stafin Akademik

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJË

Doracaku për stafin akademik shërben për të lehtësuar të kuptuarit e funksionit të stafit akademik në Universitetin "Haxhi Zeka" (UHZ). ky doracak është përpiluar si përmbledhje e pikave kyçe të të gjithë dokumenteve dhe dispozitave që ndërlidhen me stafin akademik. Universiteti "Haxhi Zeka" kujdeset që të ofroj një ambient të përshtatshëm ku stafi akademik ka të gjitha parakushtet e nevojshme për të zhvilluar aktivitetin e tyre akademik dhe shkencor.

## Pritjet profesionale

UHZ kërkon që anëtarët e tij, në kryerjen e detyrave të tyre institucionale, të respektojnë parimet e korrektësisë dhe paanësisë, duke punuar para së gjithash në interes të universitetit duke shmangur situatat e konfliktit të interesave, dhe sjelljeve jo etike në komunikim, menaxhim, punë kërkimore dhe akademike siç janë të përcaktuara me legjislacionin dhe politikat e UHZ-së duke përfshi Ligjin e Arsimit të Lartë të Republikës së Kosovës, Statutin e UHZ-së, Kodin e Etikës.

## Të drejtat dhe përgjegjësitë

Stafi akademik i UHZ-së gëzojnë lirinë e shprehjes. Ata kanë lirinë të pyesin dhe testojnë njohuritë e marra si dhe të shprehin idetë e reja, mendimet kundërshtuese pa e venë vetën në rrezik me humbjen e punës apo ndonjë privilegj që mund të kenë me UHZ-në. Stafi akademik ka të drejtën e avancimit dhe zhvillimit akademik të tij, të drejtën e trajtimit të barabartë si dhe drejtën e pushimit si është sqaruar në pjesët e caktuar të këtij Doracaku.

## Ngarkesa e punës

Në bazë të kontratës së punës, nga stafi akademik duhet të punoi 40 orë në javë, sipas orarit të përcaktuar nga punëdhënësi dhe zyrtari të cilit i raporton. Stafi akademik mund të obligohet të punojnë edhe më gjatë se orari i planifikuar i punës brenda javës, por jo më gjatë se 20 orë në javë dhe 40 orë në muaj, raste në të cilat kompensimi do të jetë në vlerë të rritur 20% për orë ose sipas kërkesës së të punësuarit me ditë të lira për muajin e ardhshëm.

Norma javore e orëve dhe lartësia e pagës sipas titujve akademik si në vijim:

Profesorët e rregullt	Profesorët e asocuar	Profesorët asistent	Lektorët	Asistentët	Mësimdhënësit e Arteve (1-3)	Asistentët në Fakultetin e Arteve
6 orë/javë	6 orë/javë	6 orë/javë	10 orë/javë	10 orë/javë	10 orë/javë	16 orë/javë

## Procedurat e Rekrutimit

Procesi i rekrutimit të stafit të rregullt është i rregulluar me Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të rregullt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.



## Pushimet

Stafit akademik i UHZ-së i takojnë pushimi ditor, javor dhe vjetor, sipas dispozitave ligjore të përcaktuara në Ligjin e punës, respektivisht kreut që rregullon pushimet dhe mungesat nga puna.

## Bilanci Jetë-Punë

UHZ kujdeset që stafi të performojë mirë duke pasur një bilancë të mirë të punës dhe jetës jashtë punës. Bazuar në nenin 33 të Ligjit të Punës, pushimi vjetor për stafin akademik shfrytëzohet në kohën e pushimeve dhe mund të zgjasë deri sa të zgjasë pushimi nëpër institucionet edukativo-arsimore.

## Barazia

UHZ angazhohet në vazhdimësi në zbatimin e parimit të mundësive të barabarta të stafit akademik, që nënkupton sigurimin e ofrimit të mundësive të barabarta si dhe mbrojtjen e të drejtave bazë që dalin nga dispozitat ligjore me të cilat rregullohet marrëdhënia e punës së stafit akademik të UHZ-së. Stafi akademik është i trajtuar në mënyrë të barabartë sa i përket pagave dhe kujdeset në ndarje të barabartë të mbi-normës, përfshirë këtu edhe rastet me nevoja të veçanta.


## Vlerërisimi i performancës

Vlerësimi i jep anëtarit të stafit akademik dhe mbikëqyrësit mundësin e afirmimit të punës së stafit akademik për UHZ, ngrit motivin dhe angazhimin e stafit akademik për një aktivitet mësimor dhe shkencor më cilësor, përcakton prioritetet e punës dhe pritjet në performancën e stafit akademik gjatë periudhës së ardhshme vjetore të vlerësimit; reflekton në përfitim, korrigjim dhe rekomandime për ndryshime të pozitive paralele në njësi/departamente të ndryshme. Vlerësimi bëhet në disa nivele:



## Zhvillimi i stafit

Zhvillimi progresiv dhe tejkalimi i sfidave, përmes zhvillimit të stafit akademik synon të rritë dhe të mbështet përsosmërinë në praktikën akademike në UHZ, përmes udhëheqjes, aftësive profesionale, hulumtimit dhe mësimdhënies, duke punuar me stafin në këto drejtime:



## Procedura Ankimore

Nëse një anëtar i stafit nuk është i kënaqur ndaj ndonjë vendimi kundrejtë tij, ai ka të drejtë ankese duke iu drejtuar instancave përkatëse, duke filluar nga komisionet përkatëse të ankesave, inspektorati i punës, apo deri te gjykatat kompetente.